REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE PËR VITIN 2010

Kuvendi i Shqipërisë, duke konsideruar se:

- procesi zgjedhor është rezultat i kontributit të përbashkët pozitiv dhe ligjor të të gjithë aktorëve, partive politike dhe shoqërisë civile në vend;
- zgjedhjet e lira, të drejta dhe të ndershme përbëjnë themelin e shtetit dhe të demokracisë;
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka një rol të rëndësishëm në organizimin dhe mbarëvajtjen e zgjedhjeve, por ky rol duhet të ketë mbështetjen dhe rolin aktiv të forcave politike, medias dhe shoqërisë civile për realizimin e detyrës së përbashkët për zgjedhje të lira, të drejta, të ndershme dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare;
- forcat politike duhet të kenë dhe të demonstrojnë aktivisht vullnetin e plotë politik për mbajtjen dhe realizimin e zgjedhjeve më të mira që ka zhvilluar Shqipëria pas viteve 90;

Konstaton se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për vitin 2010:

- ka zhvilluar veprimtarinë e tij në përputhje me përcaktimet legjislative dhe në kuadrin e një viti jozgjedhor;
- ka zhvilluar veprimtarinë për përgatitjen e zgjedhjeve vendore të radhës për vitin 2011, me qëllim realizimin e tyre në përmbushje të plotë të standardeve ndërkombëtare;
- ka miratuar/rishikuar aktet nënligjore, në kompetencë të KQZ-së, në përputhje me rekomandimet e dhëna në raportin përfundimtar të zgjedhjeve nga OSBE/ODIHR-i dhe organizmat e tjerë ndërkombëtarë;
- ka nxitur një klimë të përshtatshme bashkëpunimi dhe konsensusi brenda anëtarësisë së KQZ-së, me qëllim rritjen e fizionomisë dhe vendimmarrjes teknike të saj.

Kuvendi kërkon nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për vitin 2011:

- të mundësojë, për sa i përket aspekteve zgjedhore, të cilat me ligj janë kompetencë e KQZ-së, realizimin e zgjedhjeve vendore të datës 8 maj 2011 në mënyrë të lirë, të drejtë, të ndershme dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare;
- të vijojë dhe të konsolidojë më tej rolin profesional dhe teknik të tij, të vlerësuar ndër vite me nota maksimale nga raportet e OSBE/ODIHR-it;
- të mundësojë realizimin e një klime bashkëpunuese dhe konsensusi brenda anëtarësisë së KQZ-së, si dhe në marrëdhëniet me forcat politike, me qëllimin përfundimtar që t'i shërbejë detyrës ligjore, kompetencës dhe misionit të KQZ-së për realizimin e zgjedhjeve të 8 majit 2011, në përputhje me standardet ndërkombëtare;
- të fillojë konsultim të gjerë me aktorët politikë dhe shoqërinë civile për vendosjen e teknologjive moderne të votimit në zgjedhje në të ardhmen;
- të vijojë forcimin e bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare në funksion të përmirësimit të standardeve zgjedhore, si dhe vijimin e ndërgjegjësimit të zgjedhësve për ushtrimin e së drejtës së votës, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe standardet ndërkombëtare.

7 prill 2011

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)